Pa. nr. 08-33/2026

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga shoqëria aksionare 4iG Űr és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság, me seli të regjistruar në adresën Krisztina körút 39, 1013 Budapest, Hungari, të dorëzuar përmes Shoqërisë së Avokatëve „Toshiq i Jevtiq“ nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 09.03.2026, miratoi këtë:

AKTVENDIM

1. Konstatohet se përqendrimi, me të cilin shoqëria aksionare 4iG Űr és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság, me seli të regjistruar në adresën Krisztina körút 39, 1013 Budapest, Hungari, do të fitojë kontrollin mbi shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar HeliControl Korlátolt Felelősségű Társaság, me seli të regjistruar në adresën Lechner Ödön fasor 3, 1095 Budapest, Hungari, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi dhe programi i të ardhurave 72231300.

3.Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në vijim: Ligji), më datë 06.02.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në vijim: Komisioni) u dorëzua njoftimi për përqendrim nga shoqëria aksionare 4iG Űr és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság, me seli të regjistruar në adresën Krisztina körút 39, 1013 Budapest, Hungari, sipas të cilit kjo shoqëri do të fitojë kontrollin mbi shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar HeliControl Korlátolt Felelősségű Társaság, me seli të regjistruar në adresën Lechner Ödön fasor 3, 1095 Budapest, Hungari, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve

Komisioni filloi shqyrtimin e njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe, në bazë të të dhënave të paraqitura në njoftimin për përqendrim dhe dokumentacionit të bashkëngjitur, konstatoi sa vijon:

Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira

4iG Űr és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság është shoqëri aksionare, veprimtaria kryesore e së cilës është veprimtaria e shoqërive holding.

4iG Űr és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság ka një person juridik të lidhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përkatësisht:

Shoqërinë për shërbime të komunikimit ONE MAKEDONIJA TELEKOMUNIKACII SHPKNJP Shkup, me seli në rrugën Crvena Voda nr. 7/3, 1000 Shkup, me veprimtari kryesore – veprimtari të telekomunikacionit pa tela.

HeliControl Korlátolt Felelősségű Társaság kryen veprimtari afariste në fushën e mirëmbajtjes, riparimit dhe remontit të përgjithshëm (MRO) të mjeteve ajrore me rotorë dhe funksionon si organizatë e miratuar për mirëmbajtje në përputhje me EASA Part 145, si dhe si organizatë e miratuar për trajnim dhe dhënie të provimeve në përputhje me EASA Part 147. Veprimtaritë e saj përfshijnë mirëmbajtjen bazë, remontin e përgjithshëm, modernizimin dhe shërbimet teknike përkatëse për helikopterët që përdoren në operacione civile, policore dhe ushtarake. Ajo ofron shërbime edhe për organet kompetente hungareze dhe për operatorët ndërkombëtarë.

HeliControl Korlátolt Felelősségű Társaság nuk ka persona juridikë të lidhur dhe nuk ka realizuar të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pikat 1) dhe 2) të Ligjit.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës,* vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.
Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:
Kundër këtij aktvendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE
Mr. Малинка Силјановска Николиќ